

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7917  
E martë, 29 tetor 2024  
Çmimi 0.50

Fatmir Sopi në Hagë  
e quan hero të gjallë  
Hashim Thaçin | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

## AHMETI: PO RREZIKOHEN ARRITJET HISTORIKE TË SHQIPTARËVE NË MAQEDONINË E VERIUT | FAQE 4-5



Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në opozitë, Ali Ahmeti, u ka dërguar letër udhëheqësve të lartë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, duke shprehur shqetësimet e tij lidhur me zhvillimet e fundit politike dhe kushtetuese në Maqedoninë e Veriut.

Sipas BDI-së, letrat e dërguara nga Ahmeti adresojnë tri vendime të fundit: shfuqizimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ndalimin e identifikimit etnik në institucionet shtetërore dhe formimin e një qeverie pa përfaqësim të drejtë etnik. Po

ashtu, Ahmeti i ka dërguar një letër zyrtare edhe kryetarit të VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski, lidhur me vendimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimin e tyre mbi kohezionin ndëretnik dhe qëndrueshmërinë e vendit

**RAPORTI I PROGRESIT  
PRITET T'UA KËRKOJË  
KOSOVËS DHE  
SERBISË ZBATIMIN  
URGJENT TË  
MARRËVESHJEVE | F. 3**



**RRENA  
PA BISHT**

F. 3

BEHXHET  
SH. SHALA-BAJGORA



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SPORT**



**RODRI FITON 'TOPIN E ARTË',  
XHAKA RENDITET I 16-TI | F. 10**

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## GERB fiton zgjedhjet në Bullgari

**SOFIJE, 28 TETOR** - Partia e qendrës së djathtë në Bullgari, GERB, i ka fituar zgjedhjet parlamentare të dielën, sipas rezultateve preliminare, mirëpo asaj do t'i dihet një partner koalicioni për ta formuar qeverinë. Sipas rezultateve preliminare të komisionit shtetëror zgjedhor, GERB i ka fituar 26.08 për qind të votave. Partia reformiste, Ne Vazhdojmë Ndryshimin, ka dalë e dyta me 14.76 për qind të votave, ka thënë komisioni të hënën, pas numërimit të më shumë se 82 për qind të votave. Partia ultra-nacionaliste,

Ringjallja, ka dalë e treta me 13.8 për qind të votave. Zgjedhjet e së dielës, të shtatën katër vjet, janë mbajtur si pasojë e dështimit të partive politike bullgare që të formojnë koalicion qeveritar pas zgjedhjeve të 9 qershorit. Lideri i GERB-it, Boyko Borisov, ka falënderuar të hënën votuesit për mbështetjen, dhe ka thënë se partia e tij do ta formojë qeverinë e re. "Ne do të punojmë së bashku me të gjithë, përveç Ringjalljes", ka thënë ai. Bullgaria është udhëhequr nga qeveri jetëshkurtra prej vitit 2020,

kur protestat kanë ndihmuar në dhënien fund të koalicionit të udhëhequr nga partia GERB. Ekspertët thonë se Bullgaria ka nevojë për periudhë stabiliteti, një qeveri që funksionon si duhet, në mënyrë që të rriten fondet e Bashkimit Evropian, dhe të nisnin procedurat për adoptim të valutës euro. Planet për të hyrë në Eurozonë janë shtyrë dy herë për shkak të mosarritjes së targetit për ulje të inflacionit. Shumë votues kanë thënë se shqetësohen për mundësinë e shumë pasigurive në të ardhmen.



## OKB-ja: Bota larg cakut për luftim të ndryshimeve klimatike

**NJU-JORK, 28 TETOR** - Përpjekjet globale për t'i luftuar ndryshimet klimatike nuk janë në ritmin e duhur, kanë thënë Kombet e Bashkuara. OKB-ja i ka bërë këto deklarata pasi të dhënat e reja tregojnë se gazrat nga ngrohja janë duke u akumuluar në natyrë më shpejt sesa kurrë më parë në historinë e njerëzimit. Planet aktuale kombëtare për t'i kufizuar emetimet e karbonit vështirë se mund të ulin nivelin e ndotjes deri më 2030, është thënë në analizën e OKB-së, duke lënë pezull përpjekjet për të mbajtur temperaturën e Tokës nën 1.5 gradë celsius. Këto të dhëna janë publikuar teksa në një raport ndaras është thënë se gazrat serrë janë rritur mbi 11 për qind në dy dekadat e fundit, dhe që koncentrimet atmosferike janë rritur në nivel



rekord më 2023. Huluntuesit janë të shqetësuar se pyjet janë duke humbur aftësinë

për ta thithur karbonin, çka edhe mund të ketë kontribuar në nivele rekorde të gazit në

atmosferë. Një agjenci e OKB-së, e angazhuar për të adresuar këtë çështje, ka

analizuar planet shtetërore për ta kufizuar karbonin në rreth 200 shtete. Ekspertët bëjnë thirrje që temperatura globale të mos rritet mbi 1.5 gradë celsius meqë, sipas tyre, mund të ketë pasojë jashtëzakonisht të rrezikshme për njerëzimin. Organizata Botërore e Meteorologjisë ka thënë se hera e fundit kur Toka ka pasur koncentrimet të tilla të karbonit në atmosferë ka qenë 3-5 milionë vjet më parë, kur temperatura mesatare e planetit ka qenë 2-3 gradë më e ngrohtë sesa tani, dhe nivelet e ujit ka qenë 10-20 metra më të larta. Sipas kësaj organizate, niveli i gazrave serrë ka prekur shifra rekorde më 2023, dhe shkaktare kanë qenë zjarret pyjore në Kanada dhe kushtet klimatike të diktuar nga fenomeni El Nino.

## Egjipti propozon armëpushim dyditor në Gazë

**KAJRO, 28 TETOR** - Presidenti i Egjiptit, Abdel Fattah al-Sisi, ka propozuar një armëpushim dyditor në Gazë dhe këmbim të limituar të pengjeve, me qëllim të sigurimit të "një armëpushimi të plotë", pas më shumë se një viti të luftës mes Izraelit dhe Hamasit. Hamasi është grup palestinez që udhëheq Gazën, i shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Propozimi i bërë të dielën parasheh këmbimin e katër pengjeve izraelite që mbahen në Gazë, për të burgosur palestinezë në burgjet izraelite, dhe që më pas të zhvillohen negociata të tjera në 10 ditët në vijim, ka thënë Sisi në një konferencë për media në Kajro. Ai nuk ka treguar se plani u është prezantuar edhe zyrtarisht palëve të Izraelit apo Hamasit. Intervenimi i Sisit ka ardhur teksa Izraeli vazhdon ta godasë

territorin palestinez si dhe lufton kundër Hezbollahit në Liban. Hezbollahu, grup militant dhe parti politike që kontrollon pjesën më të madhe në jug të Libanit, është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, derisa Bashkimi Evropian e ka në listë të zezë vetëm krahun e armatosur, por jo partinë, e cila ka ulëse në Parlamentin e Libanit. Izraeli, po ashtu, ka nisur të shtunën sulme ajrore kundër armikut të përbetuar, Iranit. Këto sulme, që janë kryer si shenjë hakmarrjeje për sulmin iranian me raketë balistike më herët gjatë muajit, kanë shqetësuar gjithë botën, andaj janë shtuar thirrjet për përmbytje. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara do të takohet të hënën, me kërkesë të Iranit, teksa Teherani kërkon që kjo organizatë t'i dënojë sulmet izraelite që kanë lënë të vrarë katër ushtarë.



Liderët iranianë e kanë minimizuar rëndësinë e sulmeve, duke thënë se kanë shkaktuar dëm të kufizuar. Presidenti iranian Masoud Pezeshkian i ka thënë kabinetit të

tij se Irani nuk dëshiron luftë, por do të nisë një "përgjigje të duhur". Izraeli e ka kryer sulmin si hakmarrjeje për sulmin iranian të 1 tetorit, i cili është kryer si përgjigje për vrasjen e liderëve të Hamasit

dhe një komandanti iranian. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka thënë se operacioni ka qenë "preciz dhe i fuqishëm dhe i ka përmbytur të gjitha objektivat". Netanyahu, duke folur në një ceremoni përkujtimi për viktimat e sulmit të 7 tetorit të vitit të kaluar, të kryer nga Hamasi, i cili më pas ka nxitur luftën, është ndërprerë nga britmat e familjarëve të viktimave. Ai është në presion që të arrijë një marrëveshje që garanton lirinë e pengjeve prej Gazës. Si pasojë e sulmeve të Hamasit në jug të Izraelit, janë vrarë mbi 1 200 njerëz dhe janë marrë peng mbi 240 persona. Disa janë liruar, një pjesë konsiderohet se kanë vdekur. Nga ofensiva izraelite në Gazë janë vrarë mbi 42 000 palestinezë, kryesisht gra dhe fëmijë, sipas autoriteteve shëndetësore palestineze.

# Raporti i Progresit pritet t'ua kërkojë Kosovës dhe Serbisë zbatimin urgjent të marrëveshjeve

PRISHTINË, 28 TETOR - Komisioni Evropian do të kërkojë nga Kosova dhe nga Serbia që pa vonesa të ndërmarrin hapa për zbatimin e Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve mes tyre, e njohur si Marrëveshja e Ohrit, si dhe të obligimeve të tjera të dala nga procesi i dialogut. Kjo porosi është përfshirë në draftet e raporteve të progresit si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë, të cilat do të miratohen në Bruksel në fund të këtij muaji. Radio Evropa e Lirë u informua për tekstet e tyre, në të cilat të dyja palët rikujtohen se rrugëtimi i tyre drejt BE-së është i kushtëzuar me procesin e normalizimit të raporteve mes tyre, që tash është edhe formalisht obligim për të dyja vendet.

Në draftin e raporteve thuhet se Kosova dhe Serbia kanë marrë pjesë në dialog, por nga to kërkohej të demonstrojnë më seriozisht dhe në mënyrë më konstruktive përkushtim për të ecur përpara.

Kosovës dhe Serbisë u kërkohej t'i evitohet veprimet dhe retorikën nxitëse, që rrezikojnë stabilitetin dhe nuk janë në përputhje me dialogun dhe pajtimin.

Si pengesë në procesin e normalizimit përmendet mungesa e hapave nga ana e Serbisë për të nxjerrë para drejtësisë kryesit e sulmeve ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë, por edhe mungesa e hapave konkretë nga Kosova për ta nisur



procedurën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Procesi i normalizimit [të marrëdhënieve] vazhdon të ndikohet nga mungesa e hapave të mjaftueshëm nga ana e Serbisë për të siguruar përgjegjësi dhe për të nxjerrë para drejtësisë përgjegjësit për sulmet e dhunshme nga serbët e armatosur të Kosovës ndaj Policisë së Kosovës, më 24 shtator, 2023, në Banjskë, që ishin përshkallëzimi më i rëndë në vitet e fundit", thuhet në këtë draft-dokument.

Aty kërkohej që Serbia të bashkëpunojë plotësisht dhe të

ndërmarrë masa të domosdoshme për t'i kapur dhe për t'i nxjerrë shpejt para drejtësisë kryesit e këtyre sulmeve.

Në raport vlerësohet se tensionet në veri të Kosovës, zonë e banuar me shumicë serbe, mbeten të larta dhe përsëriten kritikata ndaj autoriteteve të Kosovës për ato që cilësohen si "veprime të pakoordinuara", të cilat thuhet se kanë nxitur tensione.

Vazhdimi i bojkotimit të institucioneve të Kosovës nga ana e serbëve konsiderohet si "prapakthim serioz i Serbisë në zbatimin e obligimeve nga dialogu".

Komisioni Evropian kërkon që palët në dialog ta respektojnë Marrëveshjen për vizitat zyrtare, t'i mundësojnë vizitat e kryenegociatorëve në territorin e vendeve të njëra-tjetres, si dhe pjesëmarrjen e Kosovës në nismat rajonale.

Bëhet thirrje, po ashtu, që funksionimi i nismave rajonale të mos ndikohet nga mospajtimet dypalëshe në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Komisioni Evropian edhe me këtë dokument vjetor i bën thirrje Kosovës që ta nisë procedurën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Aty kërkohej që

si bazë për këtë të jetë draft-statuti i propozuar nga disa vende evropiane, i cili u është dorëzuar palëve në tetor të vitit 2023.

Ky propozim, thuhet në raport, është i bazuar në shembujt më të mirë evropianë dhe është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

Ndërkaq, për propozimin që është dorëzuar nga ana e ekipit menaxhues, i përbërë nga serbët e Kosovës, thuhet se nuk ka qenë në përputhje me marrëveshjet e dialogut, ndaj kërkohej që si bazë të merret pikërisht ai që quhet "propozimi evropian".

Në draft-raportin për Serbinë thuhet se obligimet për zbatimin e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve janë pjesë formale e kornizës negociuese për anëtarësimin e Serbisë në BE, në kapitullin 35.

Kështu që për Serbinë, kapitulli 23, që ka të bëjë me sundimin e ligjit, dhe normalizimi i raporteve me Kosovën do ta kushtëzojnë dinamikën e tërë procesit të integritit të saj në BE.

Paketa e zgjerimit dhe Raportet e Progresit për dhjetë vende në këtë proces do të miratohen në takimin e Komisionit Evropian të mërkurën, më 30 tetor, në Bruksel.

Do të jetë kjo paketa e fundit që miratohet nga kjo përbërje e Komisionit Evropian pasi, së shpejti, mandatin e ri pesëvjeçar do ta nisë Komisioni me përbërje të re.

## Kthehet në Shqipëri anija me 102 kontejnerë që dyshohet se kanë mbetje të rrezikshme

TIRANË, 28 TETOR - Të hënën në Shqipëri ka arritur një anije me 102 kontejnerë që dyshohet se kanë mbetje të rrezikshme. Kontejnerët me ngarkesë rreth 800 tonë dyshohet se ishin nisur tre muaj më parë drejt Tajlandës. Çështjen e këtyre kontejnerëve e ka ngritur fillimisht Rrjeti i Aksionit të Bazelit (BAN), që gëzon ekspertizë në fushën e drejtësisë mjedisore. Ajo pati thënë më 5 gusht se ka dyshime për transportim të mbetjeve të rrezikshme nga Shqipëria drejt Tajlandës. Këto mbetje, që konsiderohen të rrezikshme, besohet se janë krijuar gjatë proceseve teknologjike nga aktiviteti i kompanisë turke 'Kurum International', në zonën e ish-kombinatit metalurgjik në Elbasan.

Më 21 gusht Prokuroria e Durrësit, bashkë me Zyrën Evropiane kundër Mashtrimit Ekonomik (OLAF), i kanë nisur hetimet.

Në shkresën e nisur nga Prokuroria drejt disa institucioneve për zbatim të ligjit, është kërkuar të zbatohet

urdhri për sekuestrim dhe që mbetjet të depozitohen në një vend të sigurt. "Është e nevojshme të sekuestrohen në cilësinë e provës materiale me qëllim kryerjen e ekspertimeve përkatëse 102 kontejnerët që janë duke u transportuar në Shqipëri me anijen 'Moliva'. Të merren masa që sendet e sekuestruara të depozitohen në një vend të sigurt", është thënë në shkresën e Prokurorisë së Durrësit.

Qeveria e Shqipërisë ka thënë disa herë se lajmet për "transportim të mbetjeve të rrezikshme" janë vetëm aludime. Vetë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pati thënë se nga Shqipëria nuk janë transportuar mbetje të rrezikshme në Tajlandë apo Kinë. "Në të dyja rastet e përfolura të transportit, nga Kosova drejt Kinës, mallrat e deklaruar si okside/hidrokside hekuri apo koncentrat zinku, janë transportuar nga Porti i Durrësit drejt porteve evropiane përmes linjave ndërkombëtare me reputacion të padyshtimtë,



dhe nuk janë bërë objekte kontrollesh në vendet e BE-së, ku janë ndaluar dhe janë magazinuar për kohësisht, por janë lejuar ta vijojnë itinerarin e tyre", është thënë në reagimin e qeverisë në shtator, duke

pretenduar se operatorët ekonomikë në Shqipëri dhe Kosovë janë përgjegjës për kontejnerët, pa përmendur specifikisht dikë me emër.

Opozita, në anën tjetër, pretendon se kompania "Kurum

International" ka shkelur ligjin për mënyrën e përpunimit të mbetjeve të rrezikshme që prodhon, ndërkohë që kompania "Sokolaj" ka shkelur ligjin, lidhur me transportin e mbetjeve toksike të rrezikshme.



# Ahmeti: Po rrezikohen arritjet historike të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në opozitë, Ali Ahmeti, u ka dërguar letër udhëheqësve të lartë shqiptarë dhe ndërkombëtarë, duke shprehur shqetësimet e tij lidhur me zhvillimet e fundit politike dhe kushtetuese në Maqedoninë e Veriut. Sipas BDI-së, letrat e dërguara nga Ahmeti adresojnë tri vendime të fundit: shfuqizimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ndalimin e identifikimit etnik në institucionet shtetërore dhe formimin e një qeverie pa përfaqësim të drejtë etnik. Po ashtu, Ahmeti i ka dërguar një letër zyrtare edhe kryetarit të VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski, lidhur me vendimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimin e tyre mbi kohezionin ndëretnik dhe qëndrueshmërinë e vendit

stabilitetit në shtetin shumetnik. Ahmeti thekson se tri vendime të fundit, planet për shfuqizimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ndalimi i identifikimit të përkatësisë etnike në institucionet shtetërore dhe formimi i një shumice qeverisëse pa përfaqësim të drejtë të komuniteteve etnike, përbëjnë kërcënime serioze për paqen dhe stabilitetin e vendit dhe të rajonit në tërësi. Ai u bënë thirrje udhëheqësve ndërkombëtarë për veprim të përbashkët për mbrojtjen e arritjeve të Marrëveshjes së Ohrit dhe të drejtave të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. "Ju shkruaj sot me shqetësim të thellë për zhvillimet e fundit politike dhe kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, të cilat rrezikojnë arritjet historike të Marrëveshjes së Ohrit dhe parimet themelore të barazisë dhe paqes në shtetin tonë shumetnik, e veçanërisht për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Planet e trishta, dhe çuditërisht të paralajmëruara nga qeveria e vendit, se Gjykata Kushtetuese pritet t'i shfuqizojë dispozitat kryesore të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, që bën

gjuhën shqipe një gjuhë zyrtare të barabartë sipas Amendamentit 5 të Kushtetutës, përbëjnë një goditje të rëndë mbi Marrëveshjen e Ohrit, barazinë, harmoninë ndëretnike dhe stabilitetin në vend. Për më tepër, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për ta ndaluar identifikimin e përkatësisë etnike të qytetarëve në institucionet shtetërore shkel parimin e të drejtave kolektive të komuniteteve etnike, dhe për rrjedhojë anulon edhe instrumentet kryesore të balancuesit dhe të mekanizmit të Badenterit, të cilët ishin në thelb të Marrëveshjes së Ohrit. Ky mekanizëm është krijuar për t'i garantuar të drejtat kolektive të komuniteteve etnike sipas realitetit demografik, duke siguruar një mbrojtje themelore ndaj çdo mbizotërimi. Gjykata kushtetuese, duke eliminuar deklarin e përkatësisë etnike, shkel vetë Kushtetutën, ku si vlerë themelore të saj ka përfaqësimin e drejtë dhe adekuat, dhe se na kthen në gjendjen para arritjes së Marrëveshjes Paqësore të Ohrit", shkruan Ahmeti në këtë letër.

Ai ka thënë se së fundmi, pas zgjedhjeve të fundit, parimi themelor i Marrëveshjes së Ohrit, që kërkon formimin e një shumice politike bazuar në përfaqësimin e drejtë të komuniteteve etnike, është shkelur rëndë. "Ky veprim nuk ka të bëjë vetëm me BDI-në, por prek parimin e përfaqësimit të drejtë, i garantuar nga Amendamenti 6 i Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut, dhe qëndron si një mekanizëm mbrojtës për ta parandaluar mbizotërimin e shumicës ndaj joshumicës.

Këto tri goditje të mëdha ndaj themeleve të Marrëveshjes së Ohrit përbëjnë një kërcënim serioz për paqen, stabilitetin, harmoninë ndëretnike dhe demokracinë multietnike në Maqedoninë e Veriut. Këto nuk janë thjesht çështje të brendshme politike, por kanë pasoja të rënda për rajonin dhe për stabilitetin e tij. Këto ndërhyrje kërcënojnë t'i zhdukun elementet kyçe të paqes dhe të barazisë, duke na kthyer në kushtet e para vitit 2001, që ishin shkaktarët e krizës dhe luftës së atij viti", ka shkruar lideri i BDI-

**EPOKA E RE****Mal QORRAJ**

**SHKUP, 28 TETOR** - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në opozitë, Ali Ahmeti, u ka dërguar letër udhëheqësve të lartë shqiptarë dhe ndërkombëtarë.

Presidentit dhe kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj dhe Edi Rama, presidentes dhe kryeministrit të Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani dhe

Albin Kurti, presidentes së Komisionit Evropian Ursula von der Leyen, kancelarit gjerman Olaf Scholz, presidentit të Francës Emmanuel Macron dhe sekretarit të Shtetit të ShBA-së, Antony Blinken.

Në këto letra Ahmeti shpreh shqetësimin e tij të thellë për zhvillimet e fundit politike dhe kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, që rrezikojnë arritjet e Marrëveshjes së Ohrit dhe parimet e barazisë dhe

# Bislmi takon zyrtaren e BE-së, flasin për rrugëtimin e Kosovës drejt integritimit evropian

PRISHTINË, 28 TETOR - Zëvendëskryeministri i Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislmi, ka pritur në takim kryesuesen e Divizionit për Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Juglindore në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS), Zuzana Michalcová Šutiaková.

Me zyrtaren nga Bashkimi Evropian, zëvendëskryeministri Bislmi bisedoi rreth aktualitetit dhe zhvillimeve në vend dhe rajon, si dhe për rrugëtimin e Kosovës në procesin e integritimit evropian. "Përgjatë bashkëbisedimit, zëvendëskryeministri

trajtoi progresin që ka njohur vendi edhe në rrafshin ekonomik, ku tashmë i kemi rreth 75 000 vende më shumë të punës, të fokusuar te punësimi i grave dhe të rinjve, e ku niveli i papunësisë është ulur nga 23.8 % sa ishte para ardhjes sonë në qeverisje, në tash vetëm 10.8 %", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Zëvendëskryeministri theksoi edhe nevojën për heqjen e masave të cilat vijnë të jenë të padrejta e të qëndrojnë në fuqi edhe pas konstatimit të përfaqësuesit të lartë të politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, në raportin e tij ku rekomandon heqjen e tyre.



## Fatmir Sopi në Hagë e quan hero të gjallë Hashim Thaçin



HAGË, 28 TETOR - Dëshmitari Fatmir Sopi, ish-anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), është marrë të hënën në pyetje nga prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Gjatë marrjes në pyetje në një çast, Sopi e ka quajtur hero të gjallë ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Këtë vlerësim, Sopi e ka dhënë kur është pyetur nga prokurori që t'i identifikojë disa persona në një fotografi të luftës në të cilën ishte edhe Thaçi. Sopi gjatë dëshmisë së tij ka thënë se në zonën ku ka vepruar ai nuk ka pasur përçarje politike përpos

misionit për luftën çlirimtare. Këtë deklaram Sopi e ka bërë kur është pyetur nga avokatja e Jakup Krasniqit, Shyamala Alagendra, se nëse ka pasur ndonjë politikë UÇK-ja që ata që ishin në LDK të konsideroheshin kolaboracionistë. "Në zonën ku kam vepruar unë nuk ka pasur asnjë përçarje politike dhe nuk ka pasur asnjë politikë përpos luftës çlirimtare dhe nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje politike në mes të radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të gjithë e kanë pasur për parti dhe për politikë luftën e drejtë çlirimtare dhe çlirimin e vendin tonë", ka thënë dëshmitari.

së. Ai ka shtuar se në këtë moment kritik bën thirrje për veprim të përbashkët dhe të vendosur për t'i mbrojtur arritjet e Marrëveshjes së Ohrit dhe të drejtat e garantuara të shqiptarëve. "Angazhimi juaj për t'i sensibilizuar partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet relevante për këtë krizë kushtetuese dhe politike është i domosdoshëm. Ju falënderoj për përkushtimin tuaj të palodhshëm ndaj çështjeve shqiptare dhe stabilitetit të rajonit", thuhet në letrën e Ali Ahmetit, kryetar i Bashkimit Demokratik për Integrim.

Po ashtu, BDI-ja ka njoftuar të hënën se Ahmeti i ka dërguar një letër zyrtare edhe kryetarit të VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski, lidhur me vendimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimin e tyre mbi kohezionin ndëretnik dhe qëndrueshmërinë e vendit. "Letra është përgjigje ndaj sfidave serioze me të cilat përballet

Maqedonia e Veriut në një moment jashtëzakonisht të ndjeshëm gjeopolitik, kur çdo tension i ri mund të ketë pasojë negative për marrëdhëniet ndëretnike dhe zhvillimin e brendshëm shtetëror. Ahmeti thekson se vendimet për heqjen e mekanizmave mbrojtës për komunitetet dhe ndryshimet në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve jo vetëm që janë politikisht të diskutueshme, por janë shumë të rrezikshme dhe të dëmshme për përparimin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë", ka njoftuar BDI-ja.

BDI-ja ka apeluar për më shumë përgjegjësi dhe pjekuri nga partitë politike dhe institucionet në këtë periudhë kritike, duke nxitur zgjidhje që do ta forcojnë bashkëpunimin dhe unitetin, dhe jo ndarjet. "Letra e Ahmetit, e cila është bashkëngjitur në tërësi në këtë deklaratë, përbën një thirrje për bashkëpunim, respekt të ndërsjellë dhe dialog konstruktiv. BDI mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e mirëkuptimit ndëretnik dhe

përfshirjes, të cilat janë themele të përparimit të Maqedonisë së Veriut dhe të ardhmes së saj evropiane", theksohet në njoftimin e BDI-së.

Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut pritet të vendosë në dhjetor lidhur me fatin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, i cili u miratua shtatë vjet më parë. Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, të shtunën tha se nuk kontestohet i gjithë ligji, por vetëm pjesa e gjyqësorit.

Me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, institucionet shtetërore në Maqedoninë e Veriut detyrohen ta lejojnë përdorimin zyrtar të gjuhëve që fliten nga të paktën 20 % e qytetarëve të vendit. Kjo përfshin gjuhën shqipe, e cila përmendet si gjuha e një pjese të konsiderueshme të popullatës dhe përkufizohet në nenin e parë të këtij ligji. Gjithashtu, ligji siguron përdorimin e gjuhëve të tjera të komuniteteve me përfaqësim më të vogël se 20 %. Ligji përcakton që elementë

zyrtarë, si monedha, pullat postare, uniformat e policisë dhe zjarrfikësve, të përfshijnë gjithashtu shkrime në gjuhën që flitet nga së paku 20 % e popullatës, një masë që përkrah identitetin gjuhësor të shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera etnike në vend.

Më 9 tetor Gjykata Kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, po ashtu, vendosi ta shfuqizojë Balancuesin, një mekanizëm softuerik që rregullonte përfaqësimin "e drejtë dhe adekuat" të komuniteteve etnike në administratën publike.

Ky mekanizëm ishte krijuar për ta zbatuar Marrëveshjen e Ohrit të vitit 2001 dhe siguronte që përqindja e punësimeve të përputhej me përbërjen etnike të popullsisë. Gjithashtu, shfuqizimi i Balancuesit ngre pikëpyetje mbi kushtetutshmërinë e dispozitave që kërkojnë mbajtjen e të dhënave mbi përkatësinë etnike gjatë punësimeve në institucionet shtetërore.

Sipas regjistrimit të popullsisë i vitit 2022, popullsia e Maqedonisë së Veriut numëron rreth 2 milionë banorë, nga të cilët 54.21 % janë maqedonas dhe 29.52 % shqiptarë, ndërsa pjesa tjetër janë pjesëtarë të komuniteteve më të vogla.

Në përgjigje të shfuqizimit të Balancuesit, koalicioni shqiptar VLEN, që është pjesë e qeverisë maqedonase, ka njoftuar se është në proces të hartimit të një ligji të ri për përfaqësim etnik. Por, përkundër këtij pohimi të koalicionit VLEN, ministri i Administratës Publike, Goran Minçev, ka deklaruar se "nuk është duke u përpiluar ligji për balancuesin ashtu siç pretendon koalicioni VLEN". "Ne edhe ashtu kishim marrëveshje me VMRO-DPMNE përpara se të fillojë koalicioni se fillimisht duhet të merremi vesh për ligjin për përfaqësim të drejtë dhe më pas, balancuesin", ka thënë javë më parë Arben Taravari, kryetar i njërit krah të Aleancës për Shqiptarët, pjesë e koalicionit VLEN.

# Zgjedhjet e Kosovës 2025: Një sfidë e fortë për partitë kryesore



Shkruan:  
Prof. dr. Fejzulla  
BERISHA

Në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 në Kosovë, partitë kryesore do të përballen me një sfidë të ashpër, dhe fushata do të nxjerrë në pah një sërë kritikash dhe shembuj konkretë që ilustrjnë tensionet dhe dallimet mes politikave të qeverisë dhe opozitës.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) është kritikuar ashpër për trajtimin e çështjeve ndërkombëtare dhe tensionet me partnerët përëndimorë. Një rast i qartë është ai i marrëdhënieve me BE-në dhe ShBA-në, të cilat kanë kritikuar mënyrën se si qeveria aktuale e ka trajtuar situatën në veri të Kosovës, veçanërisht pas përplasjeve me komunitetin serb. Disa vendime të qeverisë, si ato që lidhen me policinë në veri, kanë rezultuar në një marrëdhënie të tendosur me komunitetin ndërkombëtar, duke ngritur shqetësime për stabilitetin e vendit dhe qëndrueshmërinë e aleancave të tij.

Fokusi i opozitës në zhvillim ekonomik dhe transparencë PDK, LDK, dhe AAK kanë shtuar kritikën ndaj qeverisë për mungesën e investimeve të qëndrueshme dhe nismave për të luftuar korrupsionin. Kryetari i PDK-së, ka theksuar se "tani kemi një datë" që simbolizon fundin e "një qeverie të papërgjegjshme", duke nënkuptuar kështu dëshirën për një qeverisje të re që të sjellë stabilitet dhe rritje ekonomike. Në të njëjtën linjë, LDK ka apeluar për një ringjallje të demokracisë dhe zhvillimit ekonomik, duke kritikuar LV-në për mungesë të rezultateve konkrete.

Në maj 2024, PDK organizoi një mocion mosbesimi ndaj qeverisë për shkak të pakënaqësive me qasjen e LV-së, veçanërisht në politikën e brendshme dhe të jashtme, por tentativa për zgjedhje të parakohshme e cila... Opozita kërkoi dorëheqjen e kryeministrit aktual si kusht për shpërndarjen e parlamentit, por mungesa e konsensusit e pengoi këtë iniciativë.

Presidentja Vjosa Osmani ka theksuar rëndësinë e përkushtimit të të gjitha palëve për një proces demokratik të pastër dhe me etikë të lartë, duke ftuar qytetarët dhe partitë që të fokusohen në një proces të drejtë dhe pa incidente. Kjo thirrje për etikë dhe rregull përfaqëson përpjekjen për të ruajtur integritetin e demokracisë së re në Kosovë dhe për të përmirësuar besimin e publikut tek institucionet e vendit.

Fushata zgjedhore pritet të intensifikohet, me një fokus të veçantë në çështjet e sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomik, dhe përmirësimit të marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës. Ja disa raste konkrete që do të jenë të mundura për të ndikuar në fushatën zgjedhore të

zgjedhjeve të Kosovës për shkurtin 2025:

Në qershor 2023, tensionet në veri të Kosovës, të banuar kryesisht nga serbë, u intensifikuan kur qeveria e Kosovës vendosi të dërgojë policinë për të vendosur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në objektet e tyre. Kjo lëvizje nxiti përplasje dhe një seri reagimesh nga komuniteti serb lokal dhe nga qeveria e Serbisë, që kulmuan në dhunë dhe përleshje. Një rast konkret i përplasjeve ndodhi në Zveçan, ku qytetarë serbë u përplasën me ushtarët e KFOR-it dhe policinë e Kosovës. Ngjarja pati jehonë ndërkombëtare dhe kritikë të madhe ndaj qeverisë aktuale nga vendet përëndimore, të cilat sugjeruan qetësi dhe kërkuan tërheqje të forcave speciale për të lehtësuar dialogun. Kjo ngjarje ka dëmtuar imazhin e LV-së, pasi kritikët e akuzojnë për mungesë diplomacie dhe rritje të tensioneve.

Një tjetër çështje që ka dalë në pah është mungesa e progresit në luftën kundër korrupsionit dhe transparencës në qeverisje. Në shtator 2024, një hetim mbi shpërndarjen e kontratave publike zbuloi raste të dyshuara të favorizimeve, për

të cilat opozita ka kërkuar llogaridhënie. Për shembull, disa kompani private me lidhje të supozuara me zyrtarë të LV-së përfituan kontrata për projekte ndërtimi, duke ngritur pyetje mbi transparencën dhe integritetin e qeverisë. Opozita, kryesisht PDK dhe LDK, ka përdorur këtë situatë për të dënuar mosmarjen e masave nga ana e LV-së dhe ka bërë thirrje për një qeveri të re që të jetë më e hapur dhe e përgjegjshme ndaj popullit. Një tjetër shembull nga e kaluara që ende ndikon në perceptimin e votuesve është menaxhimi i pandemisë Covid-19. Megjithatë Kosova nuk ishte në gjendje të rëndë pandemike, opozita vazhdonte të kritikonte masat e vonuara dhe mungesën e transparencës gjatë shpërndarjes së vaksinave në vitin 2021. Rastet e preferencave gjatë shpërndarjes dhe kritikën mbi infrastrukturën e shëndetësisë kanë lënë një shije të hidhur tek votuesit, të cilët mund të mbajnë qëndrim të ndryshëm në këto zgjedhje, duke shpresuar për një sistem shëndetësor më të përmirësuar.

Çështja e papunësisë mbetet një ndër problemet kryesore në Kosovë, dhe qeveria aktuale

është përballur me kritika për mungesë të përpjekjeve konkrete në uljen e papunësisë, sidomos tek të rinjtë. Në vitin 2024, u miratua një program për të subvencionuar start-up-et dhe për të tërhequr investime të huaja, por opozita e ka quajtur atë të pamjaftueshëm dhe ka kritikuar qeverinë për shpërndarjen e pakontrolluar të fondeve që përfitojnë vetëm disa kompani të caktuara. Një rast i kritikuar ishte përzgjedhja e një kompanie pa përvojë për një projekt të rëndësishëm infrastrukturor, gjë që shkaktoi pakënaqësi të gjerë publike dhe ndikoi në imazhin e qeverisë si jo transparente.

Në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Kosovë, pritet që asnjë parti të mos arrijë të fitojë një shumicë absolute, duke bërë të nevojshëm formimin e koalicioneve. Aktualisht, disa parti kryesore, përfshirë Lëvizjen Vetëvendosje (LV), Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), janë ndër pretendentët kryesorë për të siguruar një pjesë të madhe të votave. LV, e cila është në pushtet, po përpiqet të ruajë mbështetjen e saj, ndërsa LDK ka rikthyer një pjesë të elektoratit të humbur dhe synon një rikthim më të fuqishëm në zgjedhje. Po ashtu, disa koalicione janë formuar paraprakisht, siç janë aleancat ndërmjet AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate, për të përforcuar pozicionin e tyre ndaj partive më të mëdha.

Nëse asnjëra parti nuk siguron shumicën, pritet që negociatat për një koalicion paszgjedhor të jenë të domosdoshme. LDK ka shprehur gatishmërinë për koalicione paszgjedhore për të arritur një qeverisje të qëndrueshme.

Këto raste specifike kanë krijuar një mjedis zgjedhor ku transparencja, besueshmëria dhe aftësia për të udhëhequr vendin nëpër sfidat e brendshme dhe ato ndërkombëtare do të kenë fokusin e debateve dhe të premtimeve zgjedhore të të gjitha partive.



## MKRS-ja shpërndan 604 tituj librash për 32 biblioteka

PRISHTINË, 28 TETOR - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës është mbajtur ceremonia e shpërndarjes së librave për 32 biblioteka komunale.

Shpërndarja është bërë nga fondi i Ministrisë së Kulturës, Rinës dhe Sportit.

Zëvendësministrja e kësaj ministrie, Daulina Osmani, tha se ky aktivitet është i përvitshëm

dhe shërben për pasurimin e fondit bibliotekar në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe më gjerë. "Mbi 30 biblioteka të Kosovës, duke përfshirë edhe bibliotekën e Preshevës, Ulqinit dhe Manastirit, nga sot do të kenë nga 604 tituj më shumë në dispozicionin e tyre për lexuesit. Dhurimi i këtyre titujve nga MKRS për bibliotekat e vendit

nuk nënkupton vetëm pasurimin e denjë dhe koleksioneve, por nënkupton edhe investim në dije dhe lexueshmëri e në pasurimin e ofertës sonë që ua bëjmë lexuesve dhe adhuruesve të librit", ka thënë ajo.

Kryetarja e Këshillit të Librit, Nerimane Kamberi, foli për buxhetin për librin, i cili, sipas saj, po rritet çdo ditë.



# RRENA PA BISHT



Behxhet  
Sh. SHALA-BAJGORA

**Për të mos besuar:** Mimoza Kusari u bë yll pas bisedave me spasiqët e radioiqët duke hyrë në një qark vicioz, nga rrena në rrenë. Fillimisht mohoi çdo bisedë, pastaj se ka folur shqip (patriote more), se fjala brat në shqip e ka kuptimin mik e jo vëlla prandaj Radoiçiqin e paska mik e jo vëlla. Po armik, jo se jo! Rrenë pastaj se veteranët e luftës e gëzojnë respektin dhe përkrahjen e saj ndonëse pikërisht me vëlla Radoiçiqin i përjashtojnë me vota nga rroga minimale. Rrenë fort për Bekim Haxhiun duke e bindur pikërisht Simiqin e Radoiçiqin se: “sa shumë i keq është Kamishi e ju nuk e dini...”. Rrenë se kundër saj po bëhet luftë hibride. Rrenë se fjalimet nuk shkruhen nga Dejana Mihali., dhe tjera rrena me bisht.

2. Dejana Mihali rrenë se është patriote dhe se nuk punon kundër shqiptarëve, Shqipërisë dhe Kosovës. Rrenë se nuk kontrollon politikanë, borde, udhëheqës, ambasadorë. Rrenë kur thotë se deputetët që e vijojnë kursin kundër analfabetizimit se kanë kaluar me sukses provimin e shkrim - leximit, se Arbërie Nagavci e ka mësuar përmendësh alfabetin e gjuhës shqipe, se Hekuran Shushunja e di tabelën e shumëzimit, se Rozeta Hajdari ka leje për të drejtuar makinën, se me miellin dhe vajin e humbur ka gatuar kifile dhe petulla që ia ka shitur komunës së Prishtinës. E tregon të vërtetën kur thotë se Durmishi dhe Xhelali kanë qenë ushtarë të shquar në luftën e fundit të Madagaskarit, si veteranë super të rrejshëm të UÇK-së. Rrenë

kur thotë se Martin Berishaj e ka keqpërdorur orarin e reduktive për të shitur lirë rrymën dhe për ta blerë shtrenjtë. Realisht, Dejana Mihali nuk rrenë shumë për vete sa rrenë të tjerët për të.

Presidentja e... Ukrainës: Vojsa Osmani, presidente në hije e Ukrainës në Kosovë, thuaja asgjë nuk ka bërë për Kosovën dhe shumë ka bërë për Ukrainën. Për gjenocidin në Gaza, çile guri gojën, sikur që ngjarja të ketë ndodhur në kohën e Hamilkarit dhe të të birit, Hanibalit. Më shumë se gjysmën e vitit e kalon në ekskursione politike jashtë vendit ku merr një varg me mëditje, pa asnjë rezultat të vetëm. Kur Behgjet Pacolli tha se ka biseduar me Radoiçiqin, me kërkesën e Albin Kurtit dhe Vojsa Osmanit që të sigurojë vota që kjo të bëhet presidente, Vojsa Osmani, pa u skuqur fare (sikur të ishte anemike) tha se nuk ishte e vërtetë se në kohë fushate, Pacollit mund t'i bie ndërmend gjithçka! Paturpësisht e paturpshme! Albin Kurti as që foli për Gjetin, në vend të tij u deklarua “xhakoni” i kishës ortodokse politike serbe të Universitetit të Prishtinës “Qerim Qerimi” duke gënjyer pa fije morali se: “Pacolli absolutisht nuk e thotë të vërtetën..”.

Kur pastaj Adem Hodza, deputet që ka mëshelur bira votimi në të gjitha legjislaturat dhe Fehmi Gashi, që ishte deputet i romëve thanë se kanë votuar për Vojsën presidente, pas një oferte që nuk mund të refuzohet nga Radoiçiqi si dhe kanë noterizuar të gjitha votimet e kërkuara nga Bini dhe Vojsa, nuk pati reagime institucionale, as nga anarkistët albinbythëlëpirës nga Tirana, as nga krrokamat e Parisit, as nga udhëbashi profesor e “analist” nga Amerika, as nga “ambasadori pedofil” nga Gjermania e as nga lahotari që i këndon pushtetit dhe llaskuqërisë. Çuditërisht, nuk reagan as narkomanët e Prizrenit.

**Rrena me kripë dhe vegetë:** Ministri i Forcës së Sigurisë që para disa muajve, ndonëse ende ministër, u deklarua publikisht se, që tani është i gatshëm të bëhet pjesë e listës për deputetë të VV-së, tash pasi duket shpëtoi nga hijenat e plakura nga Gjilani dhe Suhareka, me më shumë vendosmëri tha se dera e VV-së në FSK është vetëm ai, Maqedonci i Veriut. Më herët thoshte se ka shumë probleme për të siguruar ushqime për FSK-në kurse tani deklaroi se ushtarët asnjë ditë nuk kanë mbetur pa ushqim..., sigurisht falë kuzhinierve të burgosur në burgje të Kosovës që gatuan për ta. Pastaj, këto ditë dukshëm është rritur puna e gjellëtoreve “te Nazi”, te “Sabria”, dhe për bohemët e FSK-së, “te Martini”. Javellinët ende në Amerikë, nuk na duhen për aq kohë sa është në funksion “linja e kuqe (nxehtë) - hot - line, Kusari - Radoiçiq...”.

**Politikanët “gjenialë”:** Kryetarin e Pejës, si në kohën e cubave e zhdëpën dru në qendër të qytetit duke e bërë për spital. Të gjithë reagan e më së shumti politikanët, kryesisht opozita. Madje, kryetari i trafikut “Rruga e Re” tha se pas vizitës që i bëri Muhaxherit në spital u bind se ai pas rrahjes dukej të jetë më i fortë dhe më i vendosur, me një fjalë i pathyeshëm. Çfarë injoranti! Sipas tij dikush vetëm pasi të dhunohet cubçe, bëhet i fortë, i vendosur dhe i pathyeshëm. Doktorët e bëjnë tum në politikë: Një doktor i mirë, nëse hynë në politikë zakonisht bëhet politikan i keq. Madje, historia na mëson se bëhen edhe kriminelë. E kemi Dr. Mengelën e Hitlerit, dr. Karaxhiqin dhe Babiqin në Bosnje dhe Hercegovinë, Berishën në Shqipëri, Travarin në Maqedoni të Veriut, Bukoshin në Kosovë dhe një varg doktorësh. Psikiatri Isuf, më mirë të merrej me koç..t e Trampit se që, në mbrojtje lëvyrëse të Albin Kurtit, të

shpallë gazetarë paranojakë dhe dezulionistë, të sëmurë mendorë. Si psikiatër, me renome por me integritet të shembur, duhet ta ketë të qartë se të tillët nuk kanë përgjegjësi penale andaj nuk mund të jenë as të përndjekur apo të përcjellur, jo nga AKI por as nga Petriti vet.

**Megjithatë ka mjekë të mirë:** Haxhi Avdyli, fort e lavdoi Dejonën, këtë laddy Makbeth të VV-së. Tha se e përqafoi gjithmonë kur e takon, aq e dashur qenka. Nuk e di nëse Haxhiu është beqar por se është bandill, nuk kam fare dyshim. Lëreni këtë, po keni vëmendjen çka tha për Kurtin. Se qenka enciklopedi e gjallë dhe se në jetën e tij nuk paska takuar njeri më inteligjent se Kurtin. Këtë e thotë nga pozita e: “doktorit të trurit ..”. Secili që ka pasur nderin dhe kënaqësinë të përcjellë diskutimet dhe paraqitjet publike të “doktorit të trurit”, dhe nëse konsideron rrethin super intelektual në të cilin bashkëjeton doktori në fjalë, vlerësimin për Kurtin e merr si të mirëqenë dhe e thënë me një modesti të skajshme. Me këtë, doktori në fjalë duhet të emërohet kryetar i AShAK-ut, me meritë intelektuale dhe integritet profesional...të Muçivërcës. Po e sulmojnë ministren e baushtellës, Donika Shvarc sepse i paska bërë dëm Kosovës duke i humbur 400 pasaporta. Për mua ky dëm është i papërfillshëm. Ka mundur të jetë shumë më keq, merreni me mend po t'ia kishim besuar ruajtjen e katër pulave!!! Ministrin e shatit e të tërrnakopit (Bujqësisë), Faton Pecin e kam kushëri nga të parët, qes pushkë për të si me detyron Kanuni dhe Bajraku. Dhe gëzohem kur dëgjoj fjalë të mira për të. Pasi, me Donika Shvarcin i ndërroi, jek a jek dy pozita të larta institucionale (kush ia futë më korrektësisë së konkursit), gjeti kohë për ajrosje në natyrë. Kohë e bukur

për shlodhje, sidomos kur e keni shoqërimin e duhur me të cilin ndjeheni rehat dhe mirë. Ministri i mirë Peci gjeti një shoqërues ideal për të, zgjodhi një quran i cili, së paku skuqej për dallim nga disa politikanë që nuk skuqen asnjëherë. Çka të them vetëm, rrofsh ministër!

**Von Llejën, jo mirë nga veshët:** Von Llejën është bosc e madhe e BE-së, madre madrino e kupollës mafioze të BE-së. Vuçiqin e përqafoi ngrohtësisht, sikur Dejana Haxhinë, nuk e pyeti fare për Radoiçiqin dhe premtoi investime në Serbi prej 6 miliardë eurosh. Në Prishtinë Albin Kurti dhe Vojsa Osmani kërkuan që menjëherë (pa një minutë vonësë), t'i hjek sanksionet Kosovës që i kanë vendosur para më shumë se një viti. Këtu ishte një keqkuptim, ose Von Llejën nuk ishte mirë me dëgjim, ose përkthimi ishte si para Gjykatës Speciale në Hagë, ose nuk ua ka varë fare Albinin dhe Vojsës. Për të gjitha mund të besoj kurse për këtë të fundit kurrë, më tregoni vetëm një rast kur Albini dhe Vojsa nuk e kanë mbajtur fjalën!

**Trampi si Barcelona, Kamala si Reali:** Ky do të jetë rezultati i zgjedhjeve presidenciale më 5 nëntor 2024 në Amerikë. Dëgjohe mi pas zgjedhjeve!

**Isusi i Rio de Zhaneiros dhe kryqi i Bajqinës:** Artistët e bënë statujën e Krishtit dhe e vendosën në pikën më të lartë të kryeqytetit të futbollit në botë duke e shndërtuar në atraksion turistik dhe të pelegrinazhit. Rrugat, jonjerëzit dhe kovaçët e mjerë e bënë një kryq duke e vendosur në varrezat e fshatit Bajqinë, deri në atë ditë të gjithë të besimit islam. Nuk pati reagime institucionale as nga politikanët me emër të madh, por me koçë super të vogla. Ndërkombëtarët nuk u dëgjuan. Për habi, as BIK-u nuk bëri mik.

## Një muaj paraburgim për dy personat që sulmuan fizikisht kryetarin e Pejës

**PEJË, 28 TETOR** - Një muaj paraburgim u është caktuar dy të dyshuarve për sulmin fizik ndaj kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri. Lajmin për “Telegrafi”-n e ka konfirmuar zëdhënësja e Gjykatës Themelore të Pejës, Elzana Kastrati. “Dy të dyshuarve u është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaj. Vendimi për masën e paraburgimit është marrë sot”, tha Kastrati. Muhaxheri u sulmua

mëngjesin e të shtunës në rrugën “Bill Clinton” në Pejë. Ai ishte bashkë me një person tjetër, në momentin që u sulmua dhe për pasojë të dy pësuan lëndime trupore, për çka morën trajtim mjekësor. Zëdhënësi i Prokurorisë në Pejë, Shkodran Nikçi, ka thënë për “Telegrafi”-n se deri te sulmi ndaj kryetarit Muhaxheri dyshohet se ka ardhur si pasojë e një investimi të ujësjellësit nga komuna e Pejës në fshatin Stankaj të Rugovës. “Të

dyshuarit janë vëllezër dhe vijnë nga fshati Stankaj i Rugovës dhe dyshohet se për shkak të detyrës zyrtare që ka kryer kryetari i Pejës, respektivisht komuna e Pejës në zonën e Rugovës në fshatin Stankaj lidhur me një ujësjellës, dyshimet fillestare janë se për këtë arsye është sulmuar kryetari”, tha Nikçi. Ai shtoi se të pandehurit dyshohet se kanë qenë kundër këtij investimi nga komuna në këtë fshat dhe se për këtë arsye e kanë sulmuar kryetarin.



## Zeka: Qeveria e Kosovës nuk ua ka kushtuar rëndësinë e duhur investimeve kapitale

PRISHTINË, 28 TETOR - Kryetari i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk u ka kushtuar rëndësinë e duhur investimeve kapitale. Derisa thekson nevojën për investime të tilla si dhe avancim të infrastrukturës, Zeka thotë se rritja ekonomike e vendit është më e ulët se në vitin 2019. "Norma e rritjes ekonomike realisht vijon të jetë më e ulët sesa ka qenë në vitin 2019 para pandemisë. Natyrisht, baza ekonomike e vendit ka shënuar rritje në këto vitet e fundit dhe rrjedhimisht i bie që një normë prej më pak se 4 për qind me të cilën besoj se do të mbylлим vitin 2024, në aspektin e gjithëmbarshtëm do të jetë më e

madhe sesa e kemi pasur në vitin 2019, por norma e tillë, nëse flasim si përqindje vazhdon të jetë më e ulët se ajo që e kemi pasur në vitin 2019. Shtyllat kryesore në të cilat bazohet rritja ekonomike e vendit nuk po vjen në përdorim maksimal, këtu është fjala kryesisht për investimet kapitale të cilave kjo qeveri nuk u ka kushtuar rëndësinë e duhur", thotë Zeka. Ai konsideron se ritmi i investimeve kapitale është i ngadaltë, derisa thekson se në këtë drejtim duhet të ketë dinamikë më të madhe dhe, po ashtu, nisje të projekteve të reja. "Është e pashmangshme, meqë edhe shihet se ka pasur një përqendrim më të madh të qeverisë për realizimin e



projekteve të parapara me vitin 2024. Por, megjithatë, ritmi është goxha i ngadaltë dhe duhet të jetë një dinamikë shumë më e madhe dhe natyrisht nisje të projekteve të tjera. Vendi ka

nevojë për avancimin e infrastrukturës së saj transportuese dhe ky këtu duhet të jetë fokusi i Qeverisë së Kosovës, dhe jo vetëm për të avancuar infrastrukturën

rrugore dhe tjetër, por edhe për shkak të ndikimit ose efektit multiplikativ që investimet e tilla kapitale kanë gati të gjitha hallkat e zinxhirët e ekonomisë së vendit", thotë Zeka.

Ndër të tjera, Zeka thotë se përkrahja financiare që parashihet në kuadër të Planit të Rritjes mund të kushtëzohet nga zbatimi i marrëveshjeve "duke përfshirë ato me Serbinë". Ditë më parë Komisioni Evropian ka miratuar agjendat e reformave për vendet e Ballkanit Perëndimor - hap ky për t'i mundësuar pagesat e para nga Plani i Rritjes.

Për Ballkanin Perëndimor, Plani i Rritjes ka paraparë 6 miliardë euro prej të cilave Kosovës i takojnë mbi 800 milionë euro.

## Shala: Ministri Murati jo që nuk ndihmoi, por përkeqësoi edhe më shumë gjendjen e bizneseve në Kosovë



PRISHTINË, 28 TETOR - Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonomi dhe deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka kritikuar ministrin e Financave, Hekuran Muratin, duke theksuar se ai nuk ka përmbushur asnjë nga premtimet e dhëna gjatë fushatës. "Është e vërtetë që qeveria, gjegjësisht ministri i Financave nuk ka përmbajtur asnjë premtim të dhënë gjatë fushatës së tij apo edhe në vazhdim", ka thënë Shala. Shala është shprehur se qeveria ka dështuar të ofrojë zgjidhje për

problemin e furnizimit me arkë fiskale, duke theksuar se situata është përkeqësuar në vend që të përmirësohet. Ai e ka akuzuar Muratin se, përveç dështimeve në rregullimin e tregut, ka rritur tatimin mbi pronat e bizneseve, duke e bërë më të vështirë për to të funksionojnë. "Ai jo vetëm që nuk i ka ndihmuar bizneset me zgjidhjen e problemit të furnizimit me arka fiskale dhe ndryshimin e metodologjisë së furnizimit, por ai e ka përkeqësuar gjendjen e bizneseve duke rritur tatimin në

pronë për bizneset", ka thënë Shala për "FrontOnline".

Shala ka theksuar se qeveria nuk ka bërë asnjë përpjekje reale për të krijuar një ambient më të favorshëm për bizneset dhe përfundoi duke thënë se qeveria aktuale e ka vështirësuar mënyrën e të bërit biznes. "Në esencë nuk është bërë asnjë përpjekje reale që qytetarët ta gëzojnë dhe kjo qeveri e ka vështirësuar mënyrën e të bërit biznes dhe mënyrën e funksionimit të bizneseve", ka thënë Shala.

## Delegacioni i BQK-së në Uashington, në fokus të takimeve qasja në sistemin e pagesave të shpejta të BE-së

WASHINGTON, 28 TETOR - Delegacioni i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, gjatë vizitës në Uashington, u takua me drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor, Evropën dhe Azinë Qendrore në Bankën Botërore (BB), Xiaoqing Yu dhe drejtuesit e lartë Pesme, Natarajan, menaxherin për Kosovë, Paolucci me bashkëpunëtorët e tyre. Takimi u fokusua në shqyrtimin e mundësive për funksionalizimin e infrastrukturës teknike të nevojshme për qasjen në sistemin e pagesave të shpejta të BE-së, duke u mbështetur në praktikën më të mirë të aplikuara

nga bankat qendrore të Eurosistemit. Gjithashtu, u diskutuan opsionet e financimit dhe zhvillimit të infrastrukturës së sistemit të pagesave për t'i lehtësuar pagesat e shpejta vendore dhe ndërkufitare. Në këtë takim morën pjesë edhe guvernatorët dhe zëvendës-guvernatorët e Bankës Qendrore të Malit të Zi dhe Shqipërisë, si dhe ekipi teknik i Bankës Botërore që mbështet shtetet e Ballkanit Perëndimor në projektin rajonal për modernizimin e sistemit të pagesave dhe aplikimin në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA). Palët u pajtuan për bashkëpunim

të ngushtë teknik me qëllim funksionalizimin e infrastrukturës teknike që mbështet qasjen në SEPA dhe integrimin në sistemet e pagesave të Bashkimit Evropian si synim përfundimtar i përbashkët. Guvernatori Ismaili me këtë rast falënderoi ekipin e BB-së për mbështetjen e vazhdueshme ndaj BQK-së, duke mirëpritur angazhimin për financimin dhe asistencën teknike për realizimin e këtij projekti. Ky takim njëherësh përmbylli vizitën e delegacionit të BQK-së në kuadër të takimeve vjetore të FMN-së dhe BB-së, të mbajtura në Uashington.



## Mexhiti: Korridorit 8, prioritet për zhvillimin ekonomik të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 28 TETOR - Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti, ka thënë sot se Korridorit 8 është prioritet mbi prioritete për zhvillimin e vendit, në veçanti

zhvillimin ekonomik. "Unë shpreh gëzimin personal që shohim punimet e para që kanë dalë në sipërfaqe dhe me këtë mbyllet tema e Korridorit 8 si temë politike. Korridorit 8 është prioritet mbi prioritete

për zhvillimin e vendit, për zhvillimin ekonomik, ku nuk kam aspak dilemë se me Bechtel & Enka ne do të jemi dëshmitarë në javët dhe muajt që vijnë për realizimin e projektit", ka deklaruar

Mexhiti, i cili së bashku me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski dhe ambasadorin e ShBA-së, Angela Ageler, promovuan fillimin e punimeve të qeverisë në realizimin e Korridorit 8.





# Loja kush godet i fundit

Kjo lojë mes Izraelit dhe Iranit se kush godet i fundit, pa shkaktuar fatkeqësi që politika dhe realizmi nuk mundën t'i ndreqin, është si një ndeshje fëmimore me dema. Megjithatë, ajo arrin të shfryjë krenarinë e pretendentëve dhe të ofrojë një dukje normaliteti në mesin kaosit: të parandalojë një luftë totale.

Të paktën në këtë rast presioni i Joe Bidenit pati një efekt. Benjamin Netanyahu iu desh pothuajse një muaj për t'u përgjigjur – një kohë mjaft e pazakontë për Izraelin. Synimi fillestar ishte goditja e objektivave bërthamore dhe vendeve të nxjerrjes së naftës së papërpunuar, i vetmi burim që parandalon kolapsin ekonomik iranian. Në këtë rast do të ishte një luftë e vërtetë.

Objektivat ushtarake u zgjodhën pas njoftimit adekuat. Siç kishte bërë Irani dy herë në muajt e fundit kur lëshoi raketa ndaj Izraelit. Dhe siç kishin bërë izraelitët. Për çdo zhvillim, palët e interesuara do të duhet të presin rezultatit e pasigurt të zgjedhjeve amerikane: fitorja e Donald Trump ose ajo e Kamala Harris mund të ndryshojnë qasjen ndaj

mungesës së stabilitetit të Lindjes së Mesme dhe të parashikojë skenarë të rinj për të ardhmen e afërt. Vlen për këtë rajon, ashtu si për shumë të tjerë: lufta në Ukrainë, e ardhmja e NATO-s, pesha e Bashkimit Evropian, deri te tensioni në Detin e Kinës dhe Tajvanin.

Në këtë luftë të çuditshme, tensionet dhe shkaqet e mundshme të një konflikti të vërtetë mbeten të gjitha të paprekura dhe në terren: ambicia izraelite për të rrëzuar regjimin iranian; ambicia iraniane që të mbetet protagonist në rajon; Hezbollahu dhe Hamasi që Netanyahu nuk mund t'i eliminojë; dyshimet se çfarë superfuqie do të jetë Amerika pas zgjedhjeve të 5 nëntorit.

Në revistën Foreign Affairs, Karim Sadjapour, ekspert për Iranin në Carnegie Endowment në Uashington, krahason Arabinë Saudite të Mohammed bin Salmanit (39 vjeç) dhe regjimin iranian të Ayatollah Khameneit (85 vjeç); "Vizioni 2030", modernizimi ekonomik dhe social i të parit, dhe 1979, viti i revolucionit të Khomeinit nga i cili ky i fundit vazhdon të marrë frymëzim.

Pasi tentoi për dekada të tëra një ndarje të pamundur nga krizat e Lindjes së Mesme, sot



Arabia Saudite po bëhet protagonistja kryesore në rajon. Një ndryshim i lojës: vendi që mund të ndryshojë dinamikën statike të Lindjes së Mesme, çështjen shekullore midis Izraelit dhe palestinezëve, vazhdimësinë e shteteve arabe të dështuara, tribalizmin dhe krizat kronike ekonomike të shumë vendeve; konfliktet e pafundme.

Ajo që do t'i duhet Lindjes së Mesme është një marrëveshje

e madhe për sigurinë kolektive midis të gjitha vendeve. Diçka e ngjashme me atë që u krijua për Evropën nga Konferenca e Helsinkit e vitit 1975: ajo parandaloi përhapjen e Luftës së Ftohtë në një konflikt të vërtetë në kontinentin e vjetër. Megjithatë, duke parë hartën politike të Lindjes së Mesme, Helsinki është një hipotezë shumë e largët: shumë ushtri (ajo që burokracia gjeopolitike i quan "aktorë joshitetërorë"),

shumë ambicie kombëtare, shumë ndërhyrje nga fetë, që të mund të mendohet një strukturë sigurie kolektive, e pranuar nga të gjithë. Edhe reformat e princit të kurorës Mohammed bin Salman, të cilat mund të bëhen një fakt i ri, në realitet ende nuk janë pranuar nga sauditët: kalimi nga ekstremizmi i ngurtë fetar i vehabizmit në modernizimin shoqëror nuk është ende një siguri. / bota.al

# Vëllezërit Menendez, Netflix-i mund t'i lirojë nga burgu pas 35 vjetësh

Tridhjetë e pesë vjet pas vrasjes së prindërve dhe një muaj pas publikimit të një filmi dokumentar për historinë e tyre në Netflix, vëllezërit Lyle dhe Erik Menendez mund të jenë përsëri të lirë. Prokurori i qarkut të Los Anxhelosit, George Gascon i kërkoi gjykatësit të anulonte dënimin e përjetshëm. Vitin e kaluar u gjetën prova që tregonin se dy vëllezërit ishin abuzuar seksualisht nga babai i tyre.

Vendimi do të merret nga Gjykata e Lartë, por tashmë fjalët e prokurorit janë lapidare: "Mendoj se shpesh për arsye kulturore nuk besojmë te viktimat e dhunës seksuale, qofshin gra apo burra".

Më 20 gusht 1989, José dhe Mary Louise "Kitty" Menéndez, ai 45 vjeç, ajo 48, u vranë në vilën e tyre në Beverly Hills teksa shikonin televizor. Ai u godit nga gjashtë të shtëna pushke në një distancë të afërt, ajo nga dhjetë. Djemtë e tyre, 18 dhe 21 vjeç i thanë policisë se prindërit e tyre ishin vranë teksa



ata ndodheshin shkuar në kinema. Policia, për shkak të brutalitetit të ekzekutimit,


mendoi se ishte punë e mafies, por në muajt në vijim djemtë, Lyle dhe Erik, filluan të bënin

një jetë luksi, me ora Rolex, makina Porsche dhe udhëtime në Karaibe. Të afërmit filluan të

dyshonin: kur u futën në qoshe, të dy rrëfyan krimin, duke folur për hakmarrje pas vitesh abuzimi.

Në vitin 1993, gjyqi i parë përfundoi në ngërç, sepse anëtarët e jurisë nuk kishin arritur unanimitet. Një i dytë çoi në një dënim të përjetshëm pasi gjykatësi nuk e lejoi mbrojtjen të paraqiste akuza për abuzim seksual. Lyle tani është 56 vjeç, Erik është 54. Të dy janë në një burg në Kaliforninë Jugore.

Historia e tyre doli sërish në dritë me serialin e Netflix, i cili nisi nga pyetja: "Cilët janë përbindëshat e vërtetë?". Eriku kishte akuzuar produksionin se kishte gënjyer dhe shfaqur skena morbide të një marrëdhënieje incesti, në dush, mes tij dhe vëllait. Por pikërisht dokumentari ndihmoi që historia të mos binte në harresë. Sipas prokurorit të rrethit, dy vëllezërit «treguan se ishin bërë njerëz të ndryshëm. Tridhjetë e pesë vjet burg mund të konsiderohet një dënim i mjaftueshëm». / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Vesel Demaku i thotë 'Po' Kosovës

PRISHTINË, 28 TETOR, 2024 - Mesfushori defensiv i skuadrës austriake SCR Altach, Vesel Demaku ka vendosur të luajë për Kosovën. Ish-anëtari i Kombëtares U21 të Austrisë, të hënën, ka qëndruar në selinë e FFK-së, ku është takuar me presidentin Agim Ademi,

drejtorin e Kombëtares, Muharrem Sahiti dhe menaxherin e Kombëtares, Bajram Shala. Me këtë rast, Demaku ka theksuar se menjëherë pasi ka marrë konfirmimin nga shteti austriak për dyshtetësi, pa hezitim e me zemër, ka

vendosur që të luajë për Kosovën dhe të japë kontributin e tij në fanellën dardane. Presidenti Ademi e vlerësoi vendimin e Demakut dhe e përgëzoi për përkushtimin e tij për t'i kontribuar atdheut. Ai tha se lojtar me potencial si Vesel

Demaku janë gjithmonë të mirëseardhur në Kombëtaren e Kosovës. Demaku gjatë këtij edicioni ka zhvilluar 10 ndeshje në Bundesligën e Austrisë dhe ka lënë gjurmë me lojën e tij në fushën e blertë dhe pa dyshim do të jetë një vlerë shtesë për Kombëtaren e Kosovës.



## Rodri fiton 'Topin e Artë', Xhaka renditet i 16-ti

PARIS, 28 TETOR - Mesfushori i Man Cityt dhe Spanjës, Rodri, është shpallur fitues i "Topit të Artë" për sezonin 2023/2024. Spanjollli ishte i jashtëzakonshëm duke fituar në total pesë trofe me klubin dhe shtetin e tij. Rodrigo Hernandez Cascante fitoi në "Euro 2024" me Spanjën, ndërsa me Manchester Cityn fitoi titullin e Kampionit, Superkupën e Evropës për klube, kampionatin e Botës për klube. Ai kontribuoi me 12 gola dhe 14 asistime. Rodri mposhti në një garë të ngushtë yllin e Real Madridit, Vinicius Junior, që po ashtu kishte një sezon të shkëlqyer me klubin, por jo me vendin e tij. "Një ditë, i thashë babait tim se do ta lë futbollin, ëndrra ime ka marrë fund. Por, ai më tha, vazhdo deri në fund. Tani sot, unë jam këtu, më duhet ta falënderoj. Tërë ditën sot më kanë shkruar shoqëria ime, duke më thënë se 'futbolli fitoi sot'", ka



thënë Rodri. "Topi i Artë" te vajzat është fituar nga futbollistja e Barcelonës, Aitana Bonmati. Ajo e fitoi këtë çmim për herë të dytë në karrierën e saj. Trajneri më i mirë i vitit është shpallur italian, Carlo Ancelotti, i cili ka fituar Superkupën e Spanjës, La

Liga dhe Ligën e Kampionëve me Real Madridin sezonin e kaluar. Ndërsa trajnerja Emma Hayes është shpallur më e mira në botë. Selektorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës u nderua me këtë çmim pas një sezoni të suksesshëm. Emiliano Martinez



është shpallur portieri më i mirë në botë për të dytën herë me radhë. Klubi më i mirë për meshkuj u shpall Real Madridi, kurse për femra Barcelona. Ashtu si pritej, superylli spanjoll, Lamine Yamal e ka fituar trofeun "Kopa" në ceremoninë "Topi i

Artë". Ky trofe i ndahet futbollistit më të mirë të ri. Në listën e të nominuarve për "Topin e Artë" të sivjetmë ishte edhe Granit Xhaka. Futbollisti me prejardhje shqiptare u rendit i 16-ti në këtë listë, duke lënë prapa emra të mëdhenj të futbollit botëror.

## Jean-Denys Choulet emërohet përzgjedhës i Kosovës



PRISHTINË, 28 TETOR - Trajneri me shumë përvojë, Jean-Denys Choulet do të jetë përzgjedhës i Kosovës në basketboll. Ai u emërua përzgjedhës me vendim nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe do të fillojë punën në nëntor, në përgatitjet dhe ndeshjet e Kosovës A, që do t'i kenë si mysafire ndaj Zvicrës dhe Irlandës në udhëtim (21 dhe 24

nëntor). "Dardanët" kanë një fitore dhe një humbje në këtë grup parakualifikues për Kupën e Botës 2027. Jean-Denys Choulet ka nënshkruar kontratë 3 vjeçare me Federatën e Basketbollit të Kosovës. Trajneri francez Jean-Denys Choulet ka përvojë të madhe në karrierën e tij, duke fituar shumë trofe e duke drejtuar shumë skuadra. Jean-Denys Choulet është 66 vjeçar, ku gjatë

karrierës së tij, arriti të fitojë dy herë kampionatin francez, herën e parë në 2007 me Roanne dhe herën e dytë në 2017 me Élan Chalon. Më 2007 ishte shpallur edhe trajneri i vitit. Po ashtu ka drejtuar për shumë vite skuadra që kanë garuar në Kupa Evropiane, duke pasur përvojë ndërkombëtare. Me Élan Chalon ishte finalist i FIBA Europe Cup në vitin 2017.

## Vëllaznimi triumfon ndaj Prishtinës

Prishtinë, 28 tetor - Vëllaznimi shënoi fitore shumë të rëndësishme nën debutimin e trajnerit Jeronimo Sarin, duke mundur Sigal Prishtinën në kryeqytet me rezultat 85:101 (23:24, 15:26, 21:23, 26:28), në javën e shtatë të ProCredit

Superligës së Kosovës në basketboll. Prishtinasit e nisën ndeshjen më mirë, duke udhëhequr me shtatë pikë 13:6, por kuqezinjët nuk u dorëzuan për të përmbysur shifrat, ku çereku i parë përfundoi 23:24, derisa

mysafirët vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke rritur epërsinë, për të shkuar në pushim me rezultat 38:50. Në pjesën e dytë, Vëllaznimi arriti të menaxhojë epërsinë për të mos e rrezikuar fitoren dhe për të shënuar fitore

shumë të rëndësishme 85:101. Te vendasit më të mirët ishin Damiree Burns me 21 pikë e 14 kërcime dhe Daniel Lekdrenaj me 22 pikë, kurse te mysafirët më i miri ishte Trey Anderson me 22 pikë e gjashtë kërcime. Sigal Prishtina ka katër fitore e



tri humbje, derisa Vëllaznimi tri fitore e katër humbje.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë  
Me adresë Rr: Xhem Sadrija pn, Fusha e Pejës-Transit KK Pejë

Bazuar në Ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8, dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 29.10.2024, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës:

**KONKURS**

**Pozita: Zyrtar për ankesa dhe kërkesa të klientëve 1 pozitë**

Vendi punës: Istog  
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.  
Koeficienti i pagës 2.3

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon ankesat dhe kërkesat e klientëve lidhur me: faturat, shqyrtimin e borxheve dhe shkresave tjera të kësaj natyre për t'i dhënë përgjigje korrekte klientëve, gjithnjë në koordinim me shefin e faturimit dhe mbledhjes së borxheve (Inkasimit), menaxherin operativ dhe drejtorin e zyrës ligjor.
- Bashkëvepron si anëtar i komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të klientëve, duke i harmonizuar qëndrimet dhe aprovimet komformë ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Përpilon shkresa, raporte dhe procesverbale nga fushëveprimi i punës duke ju përmbytur afateve dhe domosdoshmërisë në përmbyshjen e detyrave komformë rregullave dhe vendimeve;
- Krijon mundësitë e mira për parashkrimin e kërkesave dhe ankesave të klientëve, pranon dhe drejton në komisioni për zgjedhje të ankesave-kërkesave, pas shqyrtimit të ankesave-kërkesave i njofton klientët.
- Zbaton procedurë të nevojshme për menaxhimin efiças të marrëdhënieve me konsumatorin në përputhje me rregulloret dhe aktet të tjera normative përmes së cilave rregullohen raportet e ofruesit të shërbimeve me klientë;
- Raporton punën javore, mujore dhe vjetore tek kontabilistit.
- Kryen punë të tjera me urdhëresë e kontabilistit.
- Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mbanë përgjegjësi disiplinore
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme:

- CV;
- Certifikata që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikata mbi gjendjen shëndetsore;

b. Kushtet e veçanta (kualifikimet profesionale)

- Diplom e shkollës së mesme / preferohet diplomë universitare;
- Njohja e punës me kompjuter;
- Preferohet përvojë pune në punë të ngjajshme e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Aftësia e komunikimit me pale.

**Mënyra e Aplikimit:** Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailit [krmambientikonkurset@gmail.com](mailto:krmambientikonkurset@gmail.com)  
Data e për aplikim është nga 29.10.2024 deri me 13.11.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Bordit të datës 15.03.2024 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 29.10.2024 të rishpall:

**KONKURS**

**Një (1) Inkasant-** Njësia në Skenderaj, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-03-14  
Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme  
Lartësia e pagës mujore: 350.00 € Bruto

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Bëne inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bëne zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të parregjistruara;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materiale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhëresës së eprorit të drejtpërdrejtë.

**Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjathtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës). Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendarin e përafërt të procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

**Aplikacioni i duhet bashkangjitur:**

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes.

**Afati dhe mënyra e Aplikimit:**

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njëjtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 29.10.2024 deri me 12.11.2024, ora 16:00. Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: [krmuniteti@yahoo.com](mailto:krmuniteti@yahoo.com)  
Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjeq Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letër Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shefqet Bajrami shpall të pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Ajtena Pomak shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Mati Ligoreci " Prizren.
- Ardinit Stajko shpall të pavlefshme diplomën Q.K " 11 Marsi " Prizren.
- Semra Shkurtak shpall të pavlefshme 2 dëftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Elbasan Selimi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN;  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909  
0.5L



# TRADITË QË NGA

# 1992

